

# MIMOZA AHMETI

BIBLIOTEKA

85H-32

A 41



**absurdi koordinativ**

**M.**  
MAREN  
AHMETI

RECEIVED  
MAY 14 1964  
LIBRARY OF CONGRESS

854-32  
A 41

MIMOZA AHMETI

ABSURDI  
KOORDINATIV



MARIN BARLETI, 1996

**ABSURDI KOORDINATIV**  
**MIMOZA AHMETI**

© Të drejtat e rezervuara

Realizimi grafik: Klodi Ginopulli

---

Tirazhi 5000 kopje

---

Shtypur në shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese  
"Marin Barleti", Tiranë 1996

## Përmbajtja

Absurdi koordinativ .....	9
Mesazhi telefonik .....	13
Idetë e çmendura, janë krijesat normale, të një trikoje që ia vlen të diskutohet .....	17
Qenie të ulëta dhe qenie të larta .....	21
Turpi i gjelit .....	25
Grip. Jorezonabël. ....	29
Diapozitiv. ....	33
Lajmet e orës së fundit .....	37
Vrapi në rreth .....	40
Pasiguri drejt asgjësë .....	43
Çlirimi i zemrës .....	46
Burime të ëmbla .....	51
Kureshtja diametrale .....	54
Valët ekzist .....	57
Anonimati .....	61
Substrati .....	64





## Absurdi koordinativ

Jetoj në koordinatat më absurde të njerëzimit, por mos kujtoni se unë e di këtë. Në veçanti, ajo që unë di për vetveten është pikërisht një ndjeshmëri e ndyshueshme që më jep dije të ndryshme.

Dijet konstante për mua janë të paekzistueshme, megjithëse përbëjnë bazat e konceptimit të sotëm.

Ja, më kap papritur një shpërqëndrim values dhe unë i harroj të gjitha. Në këtë gjendje përhumbjeje dija ime është një harrim i plotë, por askush nuk mund të pretendojë se në çaste të tilla unë nuk kam ndërgjegje.

Tani, pikërisht, ndërgjegjja ime shfaqet, sepse, gjer më parë, ajo ishte ndërgjegje e të tjerëve. Unë i përdor konceptet e gatshme, si të gjithë, por në ndryshim, nuk i dashuroj. Si të tilla, konceptet e

gatshme, janë për mua, thjesht mjete.

Ajo që unë dashuroj janë gjendjet e mia, dhe në gjendje, vetëm në gjendje, unë arrij të mendoj, të krijoj diçka që më në fund jep konceptimin tim. Dhe sapo unë e di çfarë konceptova, gjendja ime shuhet, ose të paktën, ajo pjesë e gjendjes që ka lidhje me konceptin përkatës.

Kështu unë nuk e di se jetoj në koordinata absurde, megjithëse e di. Duket kontradiktore, por fakti që unë jetoj në këtë vend, apo që në përgjithësi jetoj, tregon se sa absurde unë jam.

Megjithatë absurditeti sot është kaq i përhapur, saqë nuk është e mundur të mos dish asgjë.

Unë di diçka, d.m.th ndjej, dhe ajo që di, është kaq shumë qesharake saqë mund të thuash të bën të vdesësh gazit.

Studimi i së qeshurës është një ndërgjegje më vete. Një herë rashë në dashuri sepse qesha. Kisha qeshur kaq shumë saqë befas dëgjova të qeshurën time. Atë çast e ndala të qeshurën! S'më kish bërë vaki!

Logjika ime deformohet sakaq. Më duhet të mendoj në mënyrë të duhur. Rrëmbej konceptet e gatshme:

« S'ke turp! Goxha grua! Zbardh dhëmbët! Madje dhëmballët dhe...» tak, një e puthur!

Mbetesh gojëhapur.

Ndërkaq kërkon të formulosh një mendim serioz, domethënës, por dëgjon:

« Ti qesh bota!»





«Unë, bota?!»

O zot, kjo ofezë ekspresive, desha të them, ky kompliment, më shkatërron çdo qelizë dinjiteti, dhe atëherë një tjetër e qeshur përhapet nga unë, nga ato që të tundin themelesh... (Por kjo është gjendje, çfaj kam ?)



Ndoshta prandaj nuk kam bërë prokopi në karrierë, ngaqë i kaloj kufijë.

"Karrierë"!

Ja ku u shfaq një koncept i padashurueshëm. Megjithatë disa vdesin për të. Kjo fjala «vdesin», si kuptim në kontekst, më kujtoi një fallxheshë që më pati thënë:

« Ti do të bëhesh kaq mirë, saqë të tjerëve do t'u bjerë alivani i pulave.»

I pulave... Edhe në gjumë më qeshej nga kjo frazë.

Po ç'them kështu?! Mëndja ime gjezdis andej-këndej. Ju prisni nga unë një tregim, bile dhe unë, por ja, i bie legenit.

"Legen?"

Dreqi ta hajë! Gjatë gjithë kohës u ruajta dhe ja ku më doli përpara.

Nuk është fjala për një legen nga ata që përdorim në banjë për të mushur ujë. Dhe as për një legen katundarësh nga ata ku mblidhet gjiza.

Tingëllon qesharake, por unë nuk shkruaj dot për legena. Kam kohë që rrëmoj subjekte, kërkoj ndonjë tip, por.. gjithmonë më del përpara objekti i urryer.

Dua t'i shmangem, të shkruaj diçka që mund të krijojë një ndjenjë njeriu, të lumtur a të trishtuar, s'ka rëndësi, por ndjenjë njeriu, o zot. Por është e pamundur të mos më sforcojë...objekti.

Profesori i estetikës thosh që është normale të shkruash për të shëmtuarën me po atë dashuri si dhe për të bukurën. Por mua kjo më duket një gjepur. Dhe kurrë nuk ka për të ndodhur.

Ekstaza ime është diçka e rrallë, e kushtueshme dhe njëherësh lehtë e arritshme, dhe gjen kuptim gjithandej, duke u shmangur... Dhe unë e di nga se shmanget: nga ajo që profesori im quante normale.

Po unë si hallakatem kështu? Tani nuk e di as ku jam. Nuk e di ç'kërkon të thotë ky «tregimi» im, por siç ju thashë, po ta dija, tregimi im do të asgjesohej, sepse nuk do të kishte gjendje.

Qenkam në gjendje? Do të thotë: po dashuroj! Nuk do të ishte aspak për t'u çuditur sikur im shoq të hapte derën e dhomës dhe të më zinte në flagrancë.

Çdo burri i duket sikur e tradhëton gruaja, kur e sheh atë të zhytur në një gjendje...

"Tradhëti"?!

Zot i madh! Ja dhe një tjetër koncept mekanik, i paekzistueshëm, por më mirë po e lë për një herë tjetër...

Të fala absurdi!

Do të shihemi përsëri, o abshisat e mia të dashura, pa ordinatë...





## Mesazhi telefonik

Ai ishte një mesazh i shkurtër telefonik: «Të shkruani diçka për vetminë. Është tepër e rëndësishme!»

Unë akoma dhe tani e kam të vështirë të besoj se si mund t'i lihet dikujt një mesazh si ky, i pamëshirshëm, aq më tepër në mes të një dite me diell.

Ju mund të thoni përse kërkoj të jem rigorozë, përse kërkoj që moti t'i përshtatet mesazhit. Po ju nuk e dini se përfundimi im i fundit (një konkluzion i pasforcuar ky), është se qenia ime konsiston në një kushtëzim të çuditshëm nga atmosfera, saqë mund të them: Unë jam një qenie atmosferike.

Mos më thoni se të tillë janë zogjtë. Jo.

Zogjtë ashtu si dhe qentë janë qenie sociale. Ata

i nënshtrohen ekologjisë së qytetërimit dhe kanë humbur çdo pavarësi.

Tani prisni që të pohoj se unë jam ndryshe, se nuk jam e varur, dhe se nuk ka një javë që kam mësuar fjalën "ekologji"?

Jo, miq të dashur. Unë jam një specie e zakonshme, e nënshtroeshme si dhe ju, me gjymtyrë dhe fytyrë pikante si çdonjëri nga ne.

Nga ne?

Kujtoja se do të ishte e tmerrshme, por në të vërtetë e kapa fillin. Këtë nuk kuptoj: Ne!

Dua ta perceptoj këtë objekt të çuditshëm. Thonë se ai është një qenie madhore, atribut i së cilës është çdo gjë e krijuar nga dora e njeriut. Por unë në të dalloj vetëm rraskapitje dhe vazhdoj të dëgjoj zhurmën monotone të një tezgjahu që nuk e shoh. Ja, përsëri m'u shfaq objekti Ne. Është si një gjë që dua t'i afrohem, por sa më pranë e kam aq më në pluhur ajo kthehet: Ne!

Nuk dua të injoroj, por ishte një ditë rutinë ajo, si të gjitha të tjerat, kur unë e kuptova se nuk kisha lidhje më. Nuk kisha lidhje, as ndjenjë grupi. Dhe gjithë përpjekja për të pasur, kishte qënë një sforcë, mentalitet, i cili vazhdon edhe sot të mbizotërojë botën. Ndoshta kjo është arsyeja që bota qëndronte e ftohtë me mua.

Qëndronte. E theksoj.

Sepse sot, e njëjta botë është e dashur me mua. E njëjta tëhuajzuese, e cila dikur më përbuzte.

Më përbuzte? S'e besoj.



Unë i shkaktoja asaj alergji, por jo si ajo që të shkakton pushi i plepave në verë. Pushi i plepave është një alergji komode.

Ju nuk e dini ç'do të thotë reagim i të tjerëve dhe është më mirë të mos ua mësoj, sepse mund të biem në retorikë.

Përse sillem kaq rrotull? Përse them gjëra të cilat duket se s'kanë asnjë lidhje?

Po ç'mund më tepër të bëjë një qenie e gjorë me një mesazh të tillë telefonik!

Më mirë të më dërgonit një mesazh me dy fjalë: «Vrit veten!»

Ju nuk e dini se ç'mund të më shkaktojë një ndërmarrje serioze për një institucion të tillë.

Institucioni i vetmisë ka lindur bashkë me shoqërinë civile. Ky pohim (ju duket akademik?) më largon përsëri nga spektri subjektiv. Por ja, mund të shtoja, për shembull, se me ligjin e papërcaktueshmërisë fizike, mund të kapërcehen disa doza vetmie dhe se, në të vërtetë, njeriu asnjëherë nuk identifikohet me një gjë apo me një tjetër, por identifikohet midis gjërave...

Ju duket recetë? Nuk ju pëlqeu!

Po çfarë kërkoni nga unë? Të hap barkun e të nxjerr gjithë ç'ka brënda? T'ju tregoj se si më ka gërryer kjo shtazë kraharorin, se si më cfiliti në vite për pafajësinë! Këtë? Këtë kërkoni nga unë? Jo. Kjo s'do të ndodhë kurrësesi. Kurrë më!

Unë nuk shkaktoj lotë romantikë për mjerimin e nevojshëm. Çdonjeri nga ne kaloi aq mjerim sa



iu nevojtit.

Dhe mos më dërgoni më mesazhe të tilla. Etika ime ka kohë që po shkon drejt ezaurimit dhe Zoti më ruajt nga arroganca ekzibitive.

Unë jam njeri prej jush, por jo Ju, dhe ju të gjithë jeni njeri prej nesh, por jo Ne. Dhe unë nga ky shkak ju puth.



54592



## Idetë e çmendura janë krijesat normale të një trikoje që ia vlen të diskutohet

Të diskutosh dikë apo diçka, për mua do të thotë të privilegjosh. Unë privilegjoj pak njerëz, ndërsa sende, më shumë.

S'ka disa orë që bleva një unazë. Nuk kam asnjë sensasion rreth kuptimit që manifeston ky send, ndërsa forma, argjendi dhe gurët e imët me të cilët është plumbuar, më shkaktojnë një kënaqësi të veçantë gjatë perceptisionit.

Nuk është puna se kjo kënaqësi është e madhe, kënaqësia e këtij tipi nuk ka as pasion dhe as emocion nga ai që të drithmon. Është një kënaqësi e vakët, e ëmbël, por e çuditshme: një kënaqësi që vetëm të kënaq. Nuk të provokon as të nxit, siç mund të të provokojë apo të nxitë

fakti që një djalosh të hedh një shikim kuptimplotë ndërsa ecën përkrahu me të fejuarën në bulevard.

Kështu, pra, mos kujtoni se unë po çmendem nga gëzimi që bleva unazën. Asfare. Madje kam në duar edhe dy unaza të tjera argjendi të blera që më parë, por që nuk më shkaktojnë gëzim provokues.

Një herë kam pasur një triko. Ajo ishte e butë dhe ngjyrë gruri. Te bërrylat kishte copa meshine. Kjo rrobë i përputhej trupit tim për mrekulli, dhe ka qenë e rëndë për mua, kur nga përdorimi i tepërt, u detyrova një ditë të ndahem prej saj.

Jam ndarë nga shumë njerëz me lehtësinë më menefregiste që mund të mendohet, pse jo, nga disa, edhe me ndjenjë të hidhur. Po sa do të doja të ndahem nga një njeri ashtu siç jam ndarë me atë triko të dashur.

Nuk është puna te nostalgjia. Këtu ajo nuk hyn fare. Puna është tek ajo shije e ëmbël që të krijon kujtimi i kujtimit, tek ajo shije që të shijon edhe sot. E pra, nuk e mbaj mend mirë ngjyrën: ndoshta thashë ngjyrë gruri sepse i grunjtë është përfytyrimi që më krijohet, i vendosa meshinat, jo sepse ato më kujtohen saktësisht, por sepse ato ashtu u vendosën... është ëmbëlsia e kujtimit, e kuptoni?



Babai im thosh se njeriu jeton për pak njerëzi. Megjithatë unë e gjej atë te një triko. Ndoshta vetë njeriu e ka shumë të vështirë të jetë i



njerëzishëm, megjithëse kuptimi i njerëzisë buron prej tij.

Duket sikur po le mendjen pas asaj trikoje që as më kujtohet fare. Kujtesë e çuditshme kjo e imja. Kujton gjëra që as më kujtohen, marrëzira problemesh që mund të quhen po aq të marrëzishme.

Për dikë mund të shfaqem pa vlerë, qenie që merret me çikërrime.

E drejtë. Nuk e di si përfundova kështu. Më vjen për të qarë. Sytë e mi janë të mbushur me lotë, ndërsa truri me shijen e ëmbël të asaj trikoje që nuk e mbaj mënd fare.

Të gjeja një dashuri të tillë! Fshihem.

U bë e treta herë që fshihem gjatë kësaj kohe dhe ju nuk e kuptuat. Herën e parë dhe të dytë s'e di as vetë kur u fsheha, por i numërova. Herën e tretë ua tregova. Dhe meqë ndihem inferiore (nga që merrem me gjëra të parëndësishme) tani do t'ju tregoj nga se u fsheha.

M'u shfaq kujtimi i një njeriu të cilin (vetëm kujtimit tim i kujtohet, jo mua), të cilin e kam dashur. E theksoj kllapën e mësipërme (kujtimi i kujtimit). Unë jo.

Kam tmerr nga kjo që po them. Madje çfarë nuk do të jepja për të ndërprerë rrëfimin tim në këto çaste, sikur ju të mos më quanit të pafytyrë për kuriozitetin e që ju ngrita.

E gjeta! Kurioziteti juaj më tmerroi. Më ndërpreu. Më kalli frikën. Ju bëheni kuriozë vetëm



për njerëzit. Ju pëlqejnë thashethemet për ta në mënyrë të hatashme. Ju mbushin, ju ngopin, ju zbrazin. Dhe ju, me sy të skuqur nga zvoudhja betoheni se kurrë s'do të merreni me to. Por ja, ndërkaq, me trikon time vetëm sa u zbavitët, ndërsa kur nisa intrigën, desha të them kur nisa të kujtoj kujtimin e kujtimit, sytë tuaj u hapën, shqisat u ngritën.

Tani ju pritët më së fundi të hyni në pjesën ordinere të shpirtit. Kujtuat se trikoja është preteksti.

Jo miqtë e mi, jo shpirtërat e mi të dashur... (Çudi si më njomen sytë sa herë lumturohem hidhur. Ç'shijë!)

Nuk bën t'ju fus në hoje ordinere. Të gjithë shkrimtarët e bëjnë këtë gjë, prandaj raca e tyre është e përbuzur. Dhe ju vetë papushim gërmoni, raportoni, riprodhoni dhe vlerësoni ordinerinë e jetës.

Do të ndalem dhe konsistoj përsëri.

Do të thoni, e gjora, qënka psikopate, i është bërë fiksim.

Aq më bën!

Ajo ishte një triko ngjyrë gruri, me dy mëngëza meshine. I përshtatej trupit tim dhe trupi im gjithashtu. Jetuan bashkë pa u kundërshtuar. Kur u ndamë... Sa do të doja të ndahesha nga një njeri në atë mënyrë. Lotët janë mjaltë për atë triko që nuk më kujtohet.





## Qenie të ulëta dhe qenie të larta

E lartë për mua është një gjë që më detyron puna ta shoh nga poshtë. Ka të ngjarë që kjo të vlejë për të gjitha gjërat e larta. Ashtu siç e ulët të mund të më duket diçka që më detyron qejfi ta shoh nga sipër. Midis punës dhe qejfit unë kam zgjedhur atë që sigurisht të gjithë do të zgjidhnin.

Natyra ime është e përbashkët me tuajën në këtë pikë. Ne mbizotërohemi nga qejfi. Dhe ditët më të vështira janë ato kur je qejfprishur.

Gjendja qejfprishur më ka shqetësuar dikur, gjatë, shumë gjatë, aq sa që më zinte malli për një humor të mirë. Me këtë s'dua të mburrem. Me këtë dua të tregoj sesa krijesë e ulët kam qenë.

Ju duket e pabesueshme që një njeri pa zarar si unë, të pranojë ballëhapur se ka qenë një qenie e ulët?

Edhe mua, si ju, deri këtë çast që bëra pohimin më dukej e pabesueshme, por ndërsa pohova, menjëherë e gjeta veten nën pushtimin e bindjes së rritur, desha të them të kryer, që unë kam qenë një qenie e tillë.

Kjo nuk presupozon asgjë të keqe. Askujt s'i kam bërë ndonjë dëm. Por e gjitha përmbahet në atë që mua më dukej vetja qenie e ulët ngaqë puna sillej që t'i shihja të tjerët të lartë.

Nuk ishte shkak ajo që unë mendoja për veten, që të tjerët mendonin për mua të njëjtën gjë. Dikur, një shoku im, që nuk guxonte të shoqërohej me mua, më kishte thënë: "Ti ke komplekse"!

Komplekse. Kjo fjalë më irritonte gjakun. Komplekset ishin disa leqe që kur më rrëzohej zemra, më dridhej truri, prej të cilit më dhimbte koka, më erreshin sytë dhe pastaj... nuk doja të flisja me njeri.

Komplekse... komplekse. Ka qenë një ofezë ndyrë për mua kjo fjalë.

Megjithatë e gëlltisja. Të tjerët kujtonin se nuk e dëgjoja.

Më së fundi ia gjeta kuptimin:

"Kompleks" do të thosh: e ke ti fajin, që të tjerët nga qejfi të shohin nga sipër dhe ti nga ky shkak dukesh poshtë.

Dua t'ju them një sekret i cili tani nuk vlen një lek:

(Për pak e harrova sekretin sepse më mori



mendjen leku.)

Desha të them, u kujtova, për njerëzit e lartë nuk kisha kurrfar konsiderate, por kjo nuk ndryshonte asgjë në lartësinë që ata ishin vendosur. Po ashtu unë ndieja sesi ziente konsiderata në gjakun e tyre për mua, por këtë ata nuk e merrnin parasysh. Në asnjë mënyrë. Ishin dinjitozë në refuzimin e kësaj konsiderate. Dhe unë nuk e kuptoja nga ju buronte ai stoicizëm. Tani e kuptoj: Ata ishin njerëz pa komplekse.



Të ndjesh do të thotë të kompleksohesh. Ndoshta unë ndieja aq shumë nga pandieshmëria e tyre. Por ... nuk është kjo ajo që dua t'ju tregoj. Ma shpif ndjeshmëria e tepërt.

Me kalimin e viteve ndodhi diçka e çuditshme: lartësia po zhdukej dhe ultësia poashtu. Në fillim, cektësisht, mendova se po ngrihem. Por kjo ndodhi kaq menjëhershëm saqë nuk pata kohë të provoj ndjenjë të tillë. Madje nuk dallova as ndonjë drejtim.

Ku jam mendova?

Ishte një hapësirë e pafundme e qetë. Kishte frymëmarrje në vend të trupave. Përjetshmëri ishte forma.

Nuk kam qëllim të tregoj shijen e kësaj bote. Është e pamundur.

Në çastin që ajo do të mund të tregohet, bota do të humbiste kufijtë, mjerimin desha të thoja.

S'është mirë të rrëfej më tej këtë ndjesi. Është

si një magji që po e tregove prishet. Unë desha të them diçka shumë më thjeshtë se këto të gjitha: si p.sh. kur koka ju dhemb për ndonjë problem, nënvleftësojeni atë. Kam bindjen se nënvleftësimi është më tepër se gjysma e zgjidhjes. Sepse zgjidhje nuk ka. Sa herë jam përpjekur të zgjidh një problem, kam hapur me dhjetra të tjerë. Dhe kështu, për mua, të zgjidhësh do të thotë të hapësh probleme. Puna është që ato të jenë probleme më luksoze nga ato të mëparshmet. Kështu gjithmonë. D.m.th. nuk ka asgjë të veçantë për të nënvizuar, përveç faktit që s'duhet çarë kokë... Vetëm se ... Kjo nuk është se jua zgjidh problemin, me gjithë qëllimin e mirë që kisha. Padashur bëra atë që bëj gjithmonë. Zgjidh një dhe hap një mori të tjera. Zhvillo, liro, e vdis. Këtë desha të thoja. (Me këtë "vdis" mer fund çdo lloj kompleksi).





## Turpi i gjelit

Si premisë, gjithçka është e ekzistueshme. Këtë e kuptoj nga diçka e veçantë si turpi. Nëse turpi do të ishte më pak i përhapur atëherë të gjithë do të dinim të turpëroheshim.

Për mua, turpi është cilësia bazë që dallon ...

Unë po flas kot. Ligjërime të tilla kanë të bëjnë vetëm me mua.

Nuk mund të thuash diçka që vetëm ti e di çfarë do të thuash. Në fillim duhet marrë parasysh se çfarë do të thoshin të tjerët dhe pastaj duhet të thuash ashtu si ti e mendon.

Pra, ishim te turpi...

Sa turp është të merresh me atë që është turp për të gjithë!

Është e kotë. Mëse një herë mund t'i kthehem kësaj ndjesie dhe përsëri të mos e shpjegoj çfarë

është turpi për mua.

Një herë, një mik, që tani nuk e di se ç'bëhet, më tha:

- A e di: unë kam turp nga gjeli!

Në fillim qesha. Nuk e kuptova mirë ku e kishte fjalën. Por kuptova se atë e kishte parë një gjel.

- Çfarë po bëje kur të pa? - e pyeta.

- Po zbërtheja pantallonat. - tha ai.

Qesha prapë. M'u duk spekulative. Megjithatë, kushedi, ndoshta e turpëronte gjeli.

- Një ditë, kur po bëja dush, nga dritarja hyri macja e shtëpisë.

Në të vërtetë unë nuk kam turp nga macja jonë. Por ishte e çuditshme se ajo m'i kishte qepur sytë dhe më vështronte në një mënyrë të tillë, sa që m'u duk sikur kuptonte.

Nuk e di çfarë kuptonte, por befas kapa veten duke mbuluar trupin me duar, dhe megjithëse kishte kaluar shumë kohë, m'u kujtua gjeli.

Atëherë e kujtova mikun tim, të cilin kisha kohë pa e parë dhe që nuk do të guxoja më ta puthja, po ta takoja.

Herën e fundit ai më kishte thënë:

- Paske mësuar të puthësh?!

E pra, i kisha puthur faqen miqësisht në momentin e takimit, por nuk e kuptoj përse u turpërova aq shumë nga ato fjalë, dhe ndërsa ai fliste më pas, mua s'më hiqej mëndja prej tyre. Dhe është e çuditshme. Fillova të kem kujdes të





ruhem mos puthem kur takoja ndonjë të afërt a mik. Kjo druajtje për të puthurën nuk ka asnjë shpjegim për mua. Ashtu sikurse kuptimi i atyre fjalëve: "Paske mësuar..."

Dhe ka kohë që vazhdoj të çmësoj. Në të vërtetë as mësoj as çmësoj.

Shprehia ime u ndryshua nga intonacioni i atyre fjalëve, të cilat tani nuk më bëjnë më përshtypje, por ndikimi po.

Pra, jam e ndikuar. Këtë kuptova në këtë moment ndërsa u shpreha. Ka qenë një opinion i përhapur ai, për të cilin unë shfaqesha e pandikueshme. Dhe ashtu kam kujtuar dhe unë.

Është interesant sesi përfshihet njeriu në unën e tij nga një qëllim i paeksitueshëm (ai ekziston si premisë e përgjithshme) dhe ta ushqejë veten me vite nga një delir pandikueshmërie.

Por s'ka rrugë tjetër. Dashuria është gjithmonë anonime dhe manifestuese.

Qëndroj shtrirë.

Turpi shfaqet si elegancë.

Në fillim vishesh bukur dhe imponohesh. Kërkon të arrish diçka që me vite ke vetëushqyer. Por më mirë është të vishesh bukur dhe të mos ta arrish. Ta lesh të paarrirë. Ta kapërcesh, desha të thoja.

Një herë e neglizhova dashurinë, e bëra këtë pa më të voglën ndjenjë qëllimshmërie. Ndodhi pra, rastësisht, që unë ta lë pas dore egon time. Ishte fjala për një propozim.



Por dielli ishte shumë i bukur. Po perëndonte. Në të vërtetë bota po shkonte drejt gjumit. Dhe nga ky shkak ca lotë prehjeje më mbushën sytë.

Nuk e di sa kohë kisha humbur kështu, kur pashë se i dashuri im po puthte një tjetër.

Buzëqesha. M'u duk si një çamarrok që s'kish kohë për të humbur.

U harrova përsëri në orën perënduese. Më pëlqente azgjësimi i kohës në atë mënyrë.

Kur nata erdhi, një ndjenjë shkujdesjeje më kish pushtuar dhe më zuri një gjumë i lehtë shplodhës që nuk e përshkruaj.

U zgjova. Ora nuk kuptohej. Turpi ishte një kujtim i largët që po të më kujtohej do të më vinte turp.

Gjithashtu s'mu duk e papritur. Asgjë nuk më dukej e papritur. Burimisht gjithçka ekzistonte nga unë.

Që atëherë, nuk dua më një botë përtej meje. Ajo nuk është. Nuk është më as turpi që kur ajo s'është.

Por, vetëm ai gjel, ai gjel që edhe sot e imagjinoj të shikojë këmbëngulës duke e turpëruar, atë njeri që më çmësoi të puth miqtë, ai gjel do të mbetet i dashur për mua, i paharruar... Gjithmonë.





## Grip. Jorezonabël.

Mëngjesi është pa mendim. Koka e fryrë pushon në jastëk dhe dita përpara. Është i vështirë një çast si ky. Vetëm zhurmat e makinave dhe karrove hyjnë nga dritarja.

I pangacmueshëm, vazhdoj të qëndroj shtrirë dhe joreagues gjithashtu.

Ç'të bëj. Dita shtrihet përpara. Domethënë, bota është zgjuar. Dielli denjon të ndriçojë. Ndërsa vagullia ime jo.

Nuk don të kthjellohet. Nuk don të zhduket. Kjo do të thotë që unë nuk jam në gjendje. Ose jam në gjendje të pafavorshme. E pra, është kaq e bukur dita dhe kaq kryeneç vagulli im sa që nuk shkon.

Do të doja një trup të lehtë tani, të mund të ngrihej nga shtrati. Do të doja një kokë të

kthjellët, të mund t'i gëzohej diellit. Por s'është e thënë.

Dua të sjell ndërmend ndonjë ndjenjë, fytyrë, apo frazë, por asgjë s'më bie ndërmend.

Më duket këto çaste sikur masa ime është fryrë e dendësuar. Më shtypet krahu nga pesha e krahut, kofsha, kurrizi nga pesha e tyre.

Përsipër kam një jorgan të lehtë pupël. Por peshën e jorganit dhe ndriçimin e diellit nuk i perceptoj. I di përmendësh. Dhe ndërkaq vazhdoj të mbetem joperceptues dhe joreagues gjithashtu.

Koka ime peshon mbi nofull me një peshë të papërballueshme për të. Po ashtu përmendësh e di se jastëku është i butë dhe se... koka ime duhet të ketë një peshë tjetër.

Duket e pamundur të komunikosh në të tillë gjendje. Këtu nuk ka as mesazh, as ndonjë emocion.

E vetmja gjë që mund të nënvizohet është se po mos t'i dija përmendësh disa cilësi të objekteve ku jam lëshuar do të isha tani duke u grindur me to. Jorganin do ta gjuaja me shqelma, ndërsa jastëkun do ta hidhja nga dritarja.

Njeriu që do të çuditej më pak është vjehërra. Ajo madje do të kënaqej. Jo sepse do të afeksionohej nga aventura ime, por sepse do të justifikonte bindjen që ka për mua.

Në këtë botë dy janë llojet e kënaqësive: justifikimi i bindjeve ose asgjësimi i tyre. E para të përqëndron, e dyta të liron.



Pra, thashë se vjehërra do të kënaqej. Unë nuk mund të ndjej atë mënyrë se si kënaqet ajo. Sepse ajo kënaqet në mënyrën e saj. Unë di vetëm sesi kënaqem unë kur shoh atë që kënaqet.

Po ç'kam me të? As më ka ndonjë faj për gripin. Ja u teshtiva, qenka e vërtetë!

Jastëku im vazhdon të ndodhet poshtë kokës sime, ashtu sikur jorgani përsipër. Dhe nofulla është rëndë e dërmuar.

Tani e kuptova. Më është prishur shija. Madje gojën e kam të tharë.

Më kujtohet bukur (ky është kujtimi real) kënaqësia e plotë e koordinimit të shqisave; dielli, moti. Të gjitha janë bërë për njëra-tjetrën.

Më kujtohet njeriu në mal. Në mal është diçka që s'mundet kurrë të jetë në qytet.

O gjak i ambicjes, mburrje, dëshirë komunikimi, mburravece, mburravece aq shumë mburravece. Mjerim i krijesës së shtrenjtë, i kërkueshëm, i edukuar akademike, shkollave, bangove. Mjerim qytetar dhe formim civil njëherësh mjerues qytetarie.

E gjitha konsiston në këtë kordinim të çuditshëm: midis ajrit, rrezes, trupit. Në këtë rezonacë të paemërt.

Historia është e urryer sepse nuk di se ç'është rezonimi. Dhe akoma s'janë shkruar historitë, sepse janë të pashkrueshme, si kjo orë, si ky çast, që me gojë të tharë, i etur, pres të rikthehet shija, perceptimi, drita, reagimi i ngjyrës.



Të gjitha shkencat sociale janë barrë e një kafshe për punë. Pasi dihet .... gjithçka është e panevojshme jashtë emocionit. Ndërsa drita dhe jeta janë gjithmonë të pavenitshëm. Dhe zhdukja është vepër. Vepra e fundit.

P. S

*Ç'grip bastard, rezonoi më në fund.*



## Diapozitiv



E kujtoj shumë qartë që e pashë në ëndërr, por njëkohësisht kujtoj që gjatë ëndrrës unë kisha vetëdijen e qartë që po shoh një ëndërr dhe nga ky shkak (objekt), nuk jam në gjendje të dalloj nëse isha në gjumë apo zgjuar, por di që kur u zgjova, kisha ndjenjën e një realiteti të sapokaluar.

Në qoftë se nuk jam e përcaktuar për ju, do të thotë se as unë vete nuk jam në gjendje të përcaktohem më tej për këtë që ju shpreha, por kryesorja, ajo që dua të them, është e qartë, kaq e qartë saqë tani nuk e di si mund të çoj më tej një realitet të paqartë.

Realitetet e qarta më kryejnë, dhe në këtë mënyrë mbarohen me mua, sikurse në fund, dhe unë do të mbarohem me to, dhe ajo ç'ka do të mbetet prej meje (d.m.th prej tyre) është pikërisht

ajo pjesë e paqartë, e cila në thellësi përmban vazhdueshmërinë.

Ishte pasdreke, në vend që të ishte natë.

"Në vend që të ishte natë" e përdora thjesht për të nënvizuar atë që konsatimet e veçanta mund të ndodhin jo vetëm natën, por edhe në çdo orë të ditës, madje dhe pasdreke, e cila ngjan si një zonë apatike... por, pa u zgjatur, ajo ishte shija më rrumbullake dhe e plotë që kam njohur.

Gjatë ëndrrës shija ishte e mirë, por kur u zgjova shija ndryshoi, m'u duk pothuajse banale ndërsa zbulesa reale ishte e mprehtë, mund të thuash e paharrueshme.

Mund të ketë ndikime dytësore që më shtyjnë të them se shija e asaj ëndrre ishte pothuaj ordinere. Ndoshta ajo ishte vërtet një shije e mirë, por këtë më duhet ta vërtetoj pikërisht tani, pasi të riprodhoj kujtesën e asaj ëndrre në kujtesën time.

Them kujtesën e saj, sepse ajo nuk ishte një përvojë thjesht e imja. Ajo vinte tek unë si verifikim i përvojës sime nga ajo e të tjerëve, dhe ndoshta këtu fshihet sekreti i asaj shijeje jo dhe aq të përsosur, sepse ajo ishte një shije globale, një shije e të gjithëve.

Eshtë fjala për diçka speciale si lumturia.

Ky iluzion, i cili zhduket në ekzistencë, ky iluzion e udhëheq qenien në mënyrë të ndritshme.

Kështu dhe mua, kullimi i asaj drite, që unë nuk e dija se ishte ndriçimi im (sepse drita lind





nga trupat); kështu e ndiqja atë kullësë mahnje pa e kuptuar se ndiqja ymrin tim.

Më së fundi e kapa. Nuk është se zura diçka me dorë. Madje as që shihja ndonjë konturim konkret, por ja, papritur unë isha veshur në dritë, rrezatoja. Tani e kuptoja që isha unë objekti i saj, d.m.th. isha unë. Dhe të gjithë objektet konkrete tani ishin të harrueshëm, në kuptimin e dhimbjes. Ata vetëm e përkëdhelnin ndriçimin tim, kërkonin ymrin e tyre në dritën time që ishte e tyrja.

Më dehu shkëlqimi.

Ekstaza ishte e rrallë, diellore, mashkullore, megjithëse unë isha femër. Them mashkullore, sepse potencat mendohen të tilla, ose ndoshta është luksoz një paragjykim i tillë sot i bukur, nesër i shëmtuar nga barazimi i racës. Por e lëmë. Të gjitha të ndërsjellat janë reale dhe bëhen të besueshme në pikën e ekuilibrit.

I rikthehem ëndrrës.

Ishte verbuese. Lumturia po më përzihej. Desha të them se po më përzihej nga lumturia. Njeriu i gjorë, konstrukt i dobët i natyrës, viktimë virtyti në heroizëm vesi. Pra, desha të them se po molisesha. Ishte një molisje çudibërëse.

Në fillim m'i rrafshoi ngrehinat. E vetmja majë e mprehtë mbetej kuptimi, ndërsa arsyeja, d.m.th. arsyetimi, ishte shija. Kujtova se do të qëndroja gjatë kështu.

Nuk e di në u spostua dritshmëria, apo unë u



vela prej saj neveritur, kur një ditë, desha të them atë pasdreke, nën jorgan, në gjumë desha të them, e kapa veten përsëri duke u prirur, por jo pas dritës, por pas një pusi të zi.

Ishte një errësirë e thellë me yje të rrallë, të mbarueshëm, të papërfillshëm. Më joshte dhe shijonte deri në poret më të thella.

Ajër. Ajër. Ajër.

Aty kishte ajër. Toka është një planet i pafrymë. Ndoshta planetët janë trupa të lindur për të mposhtur jetën. Por, ne jse. S'më duhen. Ajo thellësi e pakaos dhe njëherësh pa asgjë të sistemuar, ajo thellësi ishte rritja, asgjësimi.

U zgjova.

Çdo gjë ndryshon në të qindën e kohës në një banalitet. Ideja e qartë u fiksua sakaq në kokën sime:



Njeriu priret drejt lumturisë dhe e harron atë diku...

Ajo që mbetet është një refleks (si shtaza) i kërkimit. Refleksi i kërkimit dominon. Refleksi. D.m.th. pakënaqësia.

Atëhere kuptova se po palosesha në dysh, si barazimi...

## Lajmet e orës së fundit

Të gjithë i kanë ngulur sytë në një ekran dhe shohin atë që quhet film



Çdo natë kështu. Unë rri anash dhe pres. Jo që të mbarojë. Filmi vazhdon pa fund. Ata ndërrojnë stacionet. Pres që ata të lodhen dhe unë, më në fund, të bie të fle gjumin e zakonshëm.

Të nesërmen...

Është po ajo e sotme e gjithë e nesërmja, e djeshme pasnesër.

Ai, inteligjent, edhe ai rri e shikon film.

Unë shoh atë, d.m.th, e shihja, tani s'e shoh, i cili, ndërsa po sheh, thotë:

"Nuk është interesant, gjëra që i di..." megjithatë nuk i shqit sytë nga objekti i përqëndrimit.

Unë, edhe unë shikoj diku, por aty ku shikimi

im ka humbur nuk ekziston asgjë e veçantë, megjithatë plotshmëria ndihet tek unë po ashtu, më pak madje, siç ndihet kurioziteti që unë s'e kam, në fytyrat e tyre.

A doni të dini diçka më tepër për veten, thotë ideja tjetër që shoqëron gjatë gjithë kohës idenë e parë.

Dua, përgjigjem unë dhe ndërkaq asgjësohet dhe ajo pak përhumbje që më mbushte, dhe unë boshatisur, syhapur ndjej se jam kjo që sapo thashë.

Ai pastaj mer edhe disa lugë sheqer të shoqërojë filmin. Dhe nuk e di nëse ha sheqerin dhe shikon filmin apo pastaj ndërkaq shikon sheqerin dhe ha filmin apo...

" Trego kujdes për vetveten " - më porositi një baba në telefon.



Të gjithë që kujdesen janë prindër, thotë ligji, megjithëse ky baba nuk është ai i vërteti, ose është pikërisht babai im, por ç'dua më tej... nuk jam kundër, por as në gjendje të perceptoj figura.

Figura, që zëvendësojnë figura. Truri im i tejnqopur në zbrazje pa zotësinë e refuzimit mbetet kallp në këtë gjendje që të paktën do të ishte fat të quhej e mjerueshme, por mungesa e intensitetit jetësor nuk më jep shansin e një arsyeje të tillë. Dhe asgjë për të ardhur keq. Veçse :

Janë orët e trëndafilave të mbrëmjes. Dhe do të ishte fat të kisha pëlqyer ndonjëherë trëndafil. Lulet aromatizojnë vdekjen. Por reale: mund të jenë nga më të bukurat orë ato të mbrëmjes.

Mishi është akoma i freskët dhe kjo apati e trurit e fsheh një refuzim fisnik në këtë mënyrë pritshmërie. Madje sapo m'u kujtua një puthje si mundësi. Qoftë dhe si mundësi kujtimi, do të ishte shpresë.

Por dyert janë mbyllur. Dera e jashtme, dyert e brendëshme, madje dhe poret.

Ka një mplakje të detyruar ky ritëm. Nuk është ritmi që më lodh. Detyrimi. Lëvizin qerpikët. Shenjë e vetme e qetësisë në orë të hapur.

Kështu aty figurat lëshojnë madje zë. Ata shohin figurat, dëgjojnë zërin por nuk mjafton: lexojnë shkronjat.

Unë nuk jam veçse as figurë, as zëri, as shkronjat... Unë nuk jam. Dhe nuk e di si ndrydhja mund t'i mposhtë kështu objektet realë, të prekshëm, me një fjalë kaq banalë, sa dhe puna ime.

Por ai, inteligjent: kthehet nga unë pikërisht tani kur kam humbur çdo pritje, sytë i ka të mbushur me lotë.

- A e shihni - thotë - Unë po qaj, e vini re si prekem!

- E vej - i përgjigjem unë, me po atë ndjeshmëri, që shoh filmin.

Unë pres që ai të ndërrojë stacion. Por për çudi nuk e bën. Dhe unë mendoj, ndoshta për të qindtën herë:

sidoqoftë nuk është aq i pafytyrë. Dhe vazhdon të shohë, ndërsa e shoh nga këpucët, që si gjithmonë nuk i heq, ndërsa sheh.

P. S: Tani as unë tani nuk i heq këpucët, ndërsa nuk shoh.



## Vrapi në rreth



Të rendësh. Në këtë përmbledhet e gjitha.  
Kujton se je vonuar. Je bërë shumë vonë  
ndërsa të tjerët janë diku, më herët.

Atëherë një dëshirë dhe turr i çuditshëm të  
rremben dhe ty. Do t'i mbërrij, do t'i kaloj do t'u  
tregoj...

Vendimet janë po aq të menjëhershme sa  
edhe nxitimi. Po çfarë, çfarë janë ato, si mund ta  
dish?

Kuota, ndoshta. Normativa. Cاقة të  
paravendosura që më parë.

Kjo "që më parë" të prish qejfin. Diku nga  
fillimi ose mesi i vrapit, të kujtohet kjo "që më  
parë" dhe ndoshta nga sforcimi i tepërt, vjen e të  
godet gjoksin "që më parë", dhe pas ca hapash, ti  
nuk ke më fuqi: e lë garën, del anash.

Anash.

Tani mund të shohësh se si vrapojnë të tjerët.

E gjitha kjo nuk është thjesht një përshtypje. Është një realitet që përsëritet periodikisht në jetën e njeriut dhe që mund të shkaktojë tradicionalizëm në këtë mënyrë.

Nesër është... e shtunë. Fiks e shtunë, dita e fundit e javës. Dua të zgjedh midis argëtimit dhe dëshirës për t'u sforcuar. Nuk jam në moshë të njomë tanimë, por më duket se kam mbetur prapa. Dilema është diçka kaq e zakonshme dhe njëherësh kaq torturuese: të studjoj nesër dhe jo të torolisem si zakonisht (argëtohem duke u torolisur).

Nuk e di përse gjatë tërë jetës dija për mua ka qenë një punë e sforcuar. Të mësosh, për mua ka qenë zgjedhë. Nuk doja të mësoja. Nuk kam dashur kurrë, megjithëse kam qenë modeli i nxënësve. Argëtimi. Vetëm ai më tërheq, më jep një gjendje fizike të mrekullueshme dhe njëherësh mendime.

Mendime. Mendime. Mendime.

Midis tyre koka ime fluturon e lumtur.

Por ato janë pa bazë. Mendime të pabazuara, nuk kanë asnjë qëllim. Madje unë mezi arrij t'i fokusoj ato, sepse ato janë gjendje. Gjendjesi, në mund ta shpreh një fjalë si kjo për atë që s'është shpikje, por është jeta ime.

S'është shpikje,ç'them! Ku ka një shpikje më të madhe se kjo. Një shpikje ideale, e panevojshme



kujt, relative. Më përket vetëm mua, por edhe unë, jo gjithmonë di ta vlerësoj. Jeta!

- Keni humbur pesë vjet - më tha njëra. -Për pesë vjet duhej të dije pesë gjuhë, dhe akoma di vetëm një.

- Vetëm një - përsërita unë e pikëlluar.

Vrapova. Desha t'i zë. Jo gjuhët, njerëzit. Po befas e ndjeva veten të lodhur, sepse kuptova që vrapoja në të kundërt. Po largohesha nga distanca ime. Po humbisja në vorbull.

Dola anash. Fryma më mirrej. Sytë më ishin veshur. Ndërsa zemra lehtësohej. Pashë si vraponin të tjerët, ndërsa veshët më jehonin "që më parë".



E shtunë nesër, mendova. Ditë argëtimi. Po përse ndihem kaq mirë menjëherë sa lejova të njoh të shtunën si argëtuese?

S'e di.

Një herë kam parë në ëndërr një frazë. Mos u bëni kuriozë të dini se si mund të shihen në ëndërr frazat. Ajo frazë ishte:

"Sado që të vraposh, nuk mund të shkosh më larg se aq sa vrapojnë të gjithë."

"Detyra është forma latente e krimit, të cilin unë e pranoj ngaqë është legjitim." ( Këtë frazën e dytë nuk e kam parë në ëndërr. Atë e njeh lëkura.)



## Pasiguri drejt asgjësë

A ju pëlqen seksi në mungesë graviteti?  
Në të vërtetë pyetja është idiote, mjaft idiote,  
pak a shumë idiote. Megjithatë unë me iu  
përgjigja:

- Jo. Sepse pesha më eksiton.

Por aspak s'ka të bëjë kjo mënyrë me mua.

Janë një mori mënyrash që s'kanë asgjë të  
përbashkët me mua, më torturojnë. Unë vetëm  
përpiqem të largohem prej tyre dhe padashur  
krijoj kështu një mënyrë, të pavarur, timen, por  
gjithsesi, ju thashë, të varur nga shmangia që më  
duhet të bëj nga mënyrat e tjera...

Jam fatkeq, e pranoj. Fakti që unë e pranoj  
fatkeqësinë më bën më pak fatkeq, sepse në këtë  
mënyrë unë marr mundimin ta arsyetoj. Duke  
arsyetuar, në një pikë të dhënë, unë harroj për



çfarë arsyesoj, shkoj diku ku lidhjet s'kanë më lidhje dhe... për çudi, shansi është i plotë që unë të mos jem fatkeq.

Moria e mënyrave asgjësohet. Nuk ka as mënyrë për mua. Dhe kështu unë shfaqem në mënyrën time për ju, sepse, për vete, të them të drejtën, në çaste të tilla, zor se mendoj se çfarë jam apo çfarë bëj.

Shija! Shija më tërheq në mënyrë të mallkuar. Marrosem pas shijes dhe shijoj, domethënë rishijoj shijet e para.

Shijet e para nuk i shijoj dot plotësisht. Njëlloj si muzikat kur i dëgjojmë për së pari. Ato janë konstatime. Unë i shijoj më vonë shijet e mia, zakonisht kur gjithçka referohet në ekuilibër, dhe atëherë rishijimi i shijeve të para, është jetë për mua.

Kujtoni se jetoj vazhdimisht sa jam gjallë? Asnjëri! Për Zotin, asnjëri. Vdekja është e përhapur në mënyrë vulgare, e përfshirë e ndërprerë... e ndërprerë vetëm në ato çaste kur krijesa e gjorë, domethënë unë, arrin të kryejë një ikje dhe nuk e di se ka ikur, dhe nuk e di se ku ikën dhe nuk e di...

Nuk e di me çfarë është i ndërtuar trupi im. Dija ime për funksionet e brendshme, desha të them: dija ime organike për organizmin tim është kaq e vakët, ndoshta dhe ajo që di është një dije dekonstruktive e panevojshme të cilën unë s'e përdor, por dua të them, m'u ndërpre mendimi,



sa rëndë është ta jetosh jetën për raporte të jashtme, shpjegime, arsyetime të mundimshme racionale, desha të them të ftohta relacione, të papërziera me ndjeshmëri fizike, ju e dini, mendimi është fizik, është trupi ai që thotë po dhe jo. Jo mendja. Por, njëkohësisht shumica as që e marrin mundimin ta kuptojnë këtë. Çuditën! Ç'është pasioni? E vuajnë pasionin. Mbizotërohen nga pasioni. Shkatërrohen. Dhe nuk dinë të marrin parasysh.

Pasioni merret. Vendoset parasysh. Vëzhgohet. Sigurisht ndërkohë ti s'ke shpëtuar nga ekstaza e tij. Por duke vëzhguar, ti mund të shpëtosh nga verbimi. Dritëshkurtësia.

Në të vërtetë të gjitha termat janë të paekzistueshëm. Tani jam bindur që "ndreq", është një koncept që përdoret në mekanikën e sendeve. Botët, racat burojnë nga një vetëndreqje e çuditshme, përsosuri dhe sens njëherësh. Kënaqësi.

E çuditshme! Ndërkaq që shkëputem shijoj. Shija e shijeve është e vetmja shije. Unë e provoj atë nganjëherë. Mund të them, shpesh. Dhe... është fat, jetë. Unë... më vjen turp ta pranoj kaq hapur: jam një i lumtur. Si thoni, a ka të drejtë njeriu të ofendojë në këtë mënyrë?





## Çlirimi i zemrës

Gjithësia është e rruzullt por çlirimi i zemrës vjen e ngadalësohet kur dëshira shfaqet haptas për të.

Le të shpresoj. Ndoshta do të harroj çfarë dua tani pikërisht, dhe çlirimi i zemrës do të ndodhë vetiu.

Ishte shi. Ndodhesha përjashta, e veshur me flokë, me mjaft flokë dhe shiun vetëm e shikoja. Vështrimi im e ndiente, ndërsa lëkura s'e prekte.

Eshtë çudi të ndjesh në këtë mënyrë.

Binte pak, por natyra qante shumë. Retë ishin përzier dhe kishte vetëm një dendësi të murme lëvizëse e palëvizshme (varej si i fokusoje sytë).

Asnjë njeri. Asnjë kujtim.

Lëvizin andej këndeje ... Lëvizin automjete.  
Zhurmë.

Jam në qytet. Por asnjë njeri, i përzemërt jo e jo, as i pranishëm, ikshëm, ndonjë rremësi e pakapshme njeriu, që nuk e shoh, por merret me mend, merret me trup, nëse është e lejueshme të krijoj të tillë marrje.

Flokët janë ndërzyer, ose truri im, ose ose... është diçka e limontë, e pakapshme që më shtyn, më alarmon, shpejton.

Jam nisur diku. Harroj përse. Përpëlitem. Kujtohem, shtohen rrudhar anash syve, peshon zemra, sapo kujtohem. Jam nisur, nisur, nisur. Duhet kryer, mbaruar, shpejtuar.

Ja dhe kjo dhe pastaj, dhe një tjetër, dhe një.

Kam lënë diku një të mirë, një shumë të mirë, një që është shumë i mirë...

E ka emrin zemër, shpirt, tru... E ka emrin që s'ka... as emër, as zemër, as shpirt...

Tru. Ka vetëm tru.

Qaj mbi të.

Qan ai dhe lotët i nxjerr unë. Zemra ime jep goditjet e tij, të më kujtojë të më pushojë... Por unë jam e ndërruar në inat. Përplas këmbët, duart, buzët, nëse mund të përplasen, madje dhe nëse mund të mos përplasen.

Fryn erë.

E ndjenjë rrobat e mia. Lëkura, flokët, mishi, fryn erë.

Erë që të sjell në vete.

Fryn era ime, e cila bëhet e përhapur për të më prekur mua, kur i prek të tjerët që më kanë



prekur.

Avullohem. Mushkëri e frymë ndërrojnë paprerë, ndërsa shoh në erë ndërrueshmërinë time të atmosferës që ndërron gjithçka.

Prapë më vjen një e qarë ngushëlluese që nuk e përdor si të tillë, sepse e egër është ta shfrytëzosh këtë mundësi, me një çorodi mëngjesi... dhe që në mëngjes, një mëngjes si ky.

Por është intensive goditja e gjuajtjes aritmike, të paskrupullt, të kotësisë e cila çuditshëm e ndërton problemin: dhe kjo, dhe kjo, dhe kjo.

Duhet bërë të gjitha.

Është i thjeshtë problemi: të gjitha, por goditja është troshitëse, idiote, si të gjitha.

Burbullon, lëviz, godet, zhurmon, shpejton.

Dhe dita bëhet mënyrë, në këtë mënyrë. Mënyrë e padashur, e urryer, praktikisht në të njëjtin drejtim të sensit të kundërt të dashurisë.

Iluzion i praruar. As dyshimi nuk ngjitet mbi të. Jo nga parimi, nga iluzioni. Kjo ndjenjë. Qorre. Aq bukurisht qorre. Esklamative verbër. Dashuria. Verbër virgjine yshtur përdalas virgjër.

Kujtoj këtë ndjenjë. Këtë ndjenjë që ermon gjak mish e seks. (Sa rrallë lulëzon kjo e fundit reale)

Pra e kujtoj. E kujtoj tamam. Mishi im e kujton. Dhe ndërsa e di që e kujtoj, vuaj. Për atë që akoma nuk arrij ta dua dhe i përkas.

Unë dua. Po s'mundem. Lotët e trurit nuk i gjejnë sytë. Sytë janë për lotët e mishit.



Ca lotë truri. Ca lotë truri të shenjtë. Si vesë nervash. Ca lotë truri të hollë. Ca lotë pa zhurmë.

Zhytem. Asnjë kujtim a shpresë nuk vlen sa thatësia e këtyre dy termave. Sepse nuk janë.

U zhyta dhe prapë nuk munda ta zë.

Kush të më ndihmojë?

Ndoshta një halë peshku mund ta freskojë trurin e një maceje por timin, çfarë?

Zhytem. Dua të ndjej ëmbëlsinë e tij. Nëse truri është i rrafshhtë, përse të jetë gjithësia ndryshe?

Por unë lëviz nëpër rrafshësi, ngjiten këpucët e mia në baltën e trurit tim, ndërsa nuk është e mundur të përjetoj sferën.

Ku jam! Ky mish i bardhë me rrjet deji, a është ky truri im? Por mua më mbyt akoma konkretësia.

Akoma jam te mishi. Mëse një herë. Kërkoj sublimen dhe bëhem viktimë ngaqë nuk mund të kërkosh vetitë e tua në objekte të tjera.

Iki tronditur. Fytyra ime tani është e prerë. Zemërimi trajton tiparet ndërsa dhimbja është shkak që s'më hyn gjë në sy.

Eshtë refuzues ai. Truri im, ju e patë, i afrohem por sapo dua ta zë, ai nuk ndodhet aty ku kujtoj unë se ndodhet.

Ah refuzimi im, mjerimi im, fati i mjerë i trurit tim.

I mjerë, i mjerë, i mjerë.

Ai është njeriu!



Unë si një zot i pamjaftueshëm e shpërdor dhe e shtyp. E eksitoj, e enjt, e deformatoj.

Ëndërra idolesh... Shtrirje eternale mbrëmjeve, netëve, mëngjeseve herët. Kur me duart e mia trupin tim shtrëngoja rreth diskut të trurit që vërvitej orbitë.

Nuk ndihej lëvizja, lënda, frymëmarrja. Lundrimi i trurit është gjithësia. Por ai është zhytur thellë në lëndë, në mish.



Godasin nevojat mbi tulin e tij, mbi tulin e tij të butë, delikat gjuajnë nevojat egra...

Kur do të vijë dita të shoh pushtetin e këtij paqtuesi! E pafaund ëmbëlsia....



## Burime të ëmbla

Jam e keqe e idhët. Më vjen keq që mbetet në shijen time kurioziteti juaj.

Asgjë nuk vlen sa kurioziteti juaj, të cilin unë pafytyrësisht e harroj duke përçmuar lidhjen që krijohet prej tij.

Në të vërtetë ju jeni shumë më pak kuriozë sesa unë. Ashtu të zhytur në botën anonime prestigjioze ju kujtoni pikërisht atë që dhe unë e kujtoj, se gjithçka e bërë funksionon për ne, veçanërisht për atë që tek unë dhe tek ju, është fiksimi juaj, imi.

Por ora lëviz dhe janë vendosur akrepa për të matur kohën, të cilët në të vërtetë kryejnë spostimin tonë, dhe ne ndjejmë atë humbje që është e vetmja ngjitje (në ngjitjen e numrave).

Zëri dobësohet, ngjyrat dhe pasioni, por



ndodh që në melodinë e qënies kumbime të imta shoqërojnë zmadhime vëllimesh të vrullshme, pafund, të vetmet krijime që zotërojmë duke shuar jetën tonë.

Dhe kjo është ndezja përjetuese.

Po ecja në rrugë.

Rrugët janë më shumë monotone se njerëzit. Po ecja në një rrugë kaq monotone saqë nuk mbetet gjë për të kujtuar përveç cilësisë që kishte monotonia e saj mono...



Ishte një rrugë e tillë monotone (si mund të zbërthejë një gjendje gjigande një rrugë e tillë!) pra ishte kaq monotone kjo grua, desha të them kjo rrugë, (gratë dhe rrugët janë e njëjta gjë: nëpër to kalohet), pra ishte kjo më monotonia grua e rrugëve, apo rrugë e gruas, rrugë monotone...

Që befaz u zhduk në një kurbë zmadhuese, në një deltë që sakaq u shpërbë bashkë me mua dhe befaz mbeti univers ideja, (universi e ndiente atë ide, valonte ndjenja e asaj ideje...) Dhe ndërsa hapej ndërkaq gjithësia, pashë trupat e lirë të patrajtë, ikshëm vërvitës pa peshë, dendësi, poterë.

Të zhveshur trupat nga pasioni lundronin.

Nuk merrja frymë, por ndërkaq mora dhe kthimi ishte i tmerrshëm menjëhershëm.

Lëkura dridhej, puprronin ethesh porët frikshëm, dhe mishi i ngrehur uritej për vdekje për vdekjen.

Sakaq u shplodha sa një jetë, apo shumë jetë.

Dhe lotët ishin gëzime qerpikësh.

O Zot! Të vdes! Të vdes! Dua të vdes!

Nuk qe psherëtimë. Ish vitale për të qenë e tillë.

Kurrë zemra s'e ka thirrur jetën në atë mënyrë.

Ishte vitale, e mashkullt, shpatulloze thirrja.

Ishte e femërt, e pshore, e bukur zhdukja!

Të zhdukem! Të zhdukem! Më në fund e kuptova!

Në zhdukje përmbahej ekstaza e jetës. Të futem në valë azgjësie, në rryma trupash që tërheqin nga brënda ndaj njëri-tjetrit paqe.

O Zot! Kur do të mbarojnë këto zhurma!

Jeta e njeriut është zhurmë. Dhe veshët e njeriut e prodhojnë atë. Të gjitha shqisat prodhojnë kaocinë. E cila e vret trurin. (Ç'mu kujtua ky dashnor i vetëm, që unë e lë pas dore).

Po ç'është kështu! Ç'është kjo rrëmujë që përhapet nga unë! Ky tingull mistik që ndërhyt sakaq:

"Do zhdukesh shpejt e vogla ime qenie. Do të zhdukesh, por më parë mëso të mos të të vijë keq!"





## Kureshtja diametrale

Donte të dinte problemin menjëherë, drejtpërdrejt, me një logjikë kaq precize, lakonike, saqë mund të bie në përsëritje pa fund, në rast se përpiqem të spjegoj atë se çfarë donte të dinte ai.

- Do ta mësosh, -i thashë,- por më parë, mëso se nuk është ashtu siç mendon ti.

- Po si është atëhere? - ngulmoi ai.

Unë desha të gjej ndonjë lidhje fjalësh, (apo të gjesh një sidomos), por një kopicë fjalësh të përdorura më errën sytë (fjalët e përdorura janë më të bezdisshme se rrobot e përdorura) desha pra të përgjigjem, por ngaqë nuk i përdor rrobat e përdorura, fjalët e përdorura, desha të them, ai tha:

- E sheh që je fajtores?

- Unë nuk shoh, - iu përgjigja,- unë dalloj.

- Kjo është një përgjigje qorri! - ma ktheu ai.  
Në të vërtetë as sot e kësaj dite nuk e di problemin për të cilin më pyeti dhe aq më pak përgjigjen. Por diçka është e qartë për mua:

Mënyra.

Ishte e paskrupullt.

Dhe kur mënyra është e tillë, nuk mundesh as të mendosh. Logjika ime me vite ka agjëruar, dhe sa për burgjet, ju siguroj: si fenomen janë psiqikë...

Nuk dua të flas për izolimin, sepse kështu krijoj një izolim të ri, por dua të them se ajo pyetje të cilën unë nuk e mbaj mënd, vazhdon të më bëhet dhe sot e kësaj dite, dhe unë megjithëse nuk e di kuptimin e pyetjes, përgjigjen aq më pak, për diçka jam e bindur:

- Nuk është ashtu siç e mendoni.

Në të vërtetë pyetjet lindin nga vetëmbrojtja. Pyetja është një gjezur, nuk ekziston. Një gjezur e drejtpërdrejtë, tenton të godasë m'u në zemër të problemit, por në këtë mënyrë absorbohet në të.

- Më do? - më pyeti ai.

Kjo është një pyetje që unë e mbaj mend si lidhje fonemash. Në të unë nuk gjej kurrfarë kuptimi.

Dua të përgjigjem por pingu i fjalëve të përdorura nuk lëviz. Atëhere ç'mund të them! Unë dalloj përbuzje në sytë e tij, përbuzje që s'ka të bëjë me mua. Vetëm kaq kuptoj: mënyra, nuk



ka lidhje me mua.

Dhe prapë me vete përsëris:

Nuk është ashtu siç mendon ti!

Për çudi, ai që më bëri pyetjen largohet duke më lënë buzë pirgut të fjalëve të përdorura.

Harresa zmadhon volumet sakaq dhe unë nuk i gjej kuptim as mundimit për të kuptuar, por ... një e qeshur aty përjashtë, flagrante, e papritur, provokuese, një e qeshur femre...ma kujton figurën e atij që më bëri pyetjen, figurën e turbullt fonetike si pyetja "Më do?" dhe ndërsa një shpejtim ma thekson gjakun, ndërmend lëvizin të lehta fjalët, fjalët e sapogjetura: do të shpëtosh, do të shpëtosh nga unë...do të shpëtoni...

Pastaj kjo unë përmbush atë që është harresa ime (kaq jam unë, harresa ime). Dhe asgjë më tej s'më kujtohet. Kujtohet... Përmendësh e di atë lloj mënyre direkte, pa skrupull. Nuk e kuptoj dhe ndoshta nga kjo nuk pengohem prej saj duke mos penguar... në atë pëhumbje që gjithsesi... nuk është ashtu siç e mendoni ju...



## Valët ekzist

Më së fundi më duhet ta pranoj ekzistencën e tyre dhe ky është tregues që unë po hyj në ekzist ... E çuditshme! Kam prindër. S'di se si rrojnë, ku janë, ku i kam lënë, më kanë lënë, por tani pikërisht, që gjithçka midis meje dhe tyre ka humbur, njëherësh lind perceptioni real i qenies së tyre që s'ka rëndësi se ku, por rëndësia e qenies së tyre është e plotë. Unë tani i perceptoj tërësisht, i shikoj, vështrimi im i përmbledh, mendja ime i di, trupi im i përmban, ndërsa gjithçka i ndjej e përcjell në ekzistencën time, më në fund e sqaroj fizikisht, atë lidhje që me vite fiziku im e zhdukte: nuk i dua, nuk i afroj, duke mos i dashur, duke mos i pohuar, u bëra ky që jam, dhe së fundi i pranoj, i pohoj, ata, asgjënë time, vlerën e parëndësishme, të injoruar, nga ajo që është freski,



që merr fund, pikërisht tani që i pranoj, trupat e dashur akoma të gjallë, buzë vdekjes, të prindërve të mi, tani dhe unë jam nisur nëpër atë rrugë...

Kam turp. Egot e tyre të lulëzueshme, me vite u rritën egërsisht tek unë të meshtekna të lira në plotfuqi besuese, tani vogëlsisht lulëzuese, zvogëluese, gjithmonë e më shumë, egot e tyre që i zmadhoja, ua kultivoja ëndrrat me farë rinie, në nënvleftësim e sipër.



Bota ishte një lëmsh që ma morën nga dora!  
Dua t'ju them se i dua, d.m.th. se e dua shumë veten, ngaqë ndjej të rritet aq shumë anonimati im. Humb emri, humbin dhe ata emrin. Një njeri i thjeshtë midis turmës, dhe kjo, "një njeri", vlen sa për ty.

I rrotulloj në duar ikonat akoma të freskëta të fytyrave të tyre. Ua di mishin, ngjyrën, vështrimin. Ka shumë grurë në fytyra ditësh...

Humbem. Mishi im si të gjithë llojet e mishrave hollon muskulin. Kjo është e thjeshtë, pa farë domethënie. Por ndjeshmëria preket trishtë.

Ti tani mbetesh më shumë se kurrë me veten. Armiqësitë si këlyshë janë rritur, kanë marrë udhët, të kanë braktisur dhe macja e madhe e dashurisë po rripet poashtu.

I sheh pinjollat bulevardit. Ata s'e dinë se mishi i tyre këndon këngën e pranverës dhe se çdo epokë është një rit. Rit. Dhe kaq.

Dua të sqaroj babanë, por buza dridhet.



Prindi në të gjitha hapat që hedh pas (prindi ecën pas gjithmonë) pra, në të gjitha hapat, vetëm e zmadhon vështrimin, duke e gëlltitur birin për idolin e vet:

Bir, ku ke mbërritur?

Bir, sa je bërë?

Në fillim, ti me sy të freskët, ia freskon vështrimin. Pastaj ai dëgjon emrin tënd. Ka uri ta dëgjojë. Sa më shumë. Nga goja e çdokujt.

Thojani një prindi emrin e birit, një, dy, tri herë... Thojani shpesh, thojani vetëm një herë, dhe ai do të harrojë se ka skeptër në botë.

Por unë e di. Tani as veshët, as sytë dhe as zemra nuk e troket më besimin. Tani ai nuk pret asgjë veç fatit të vet në fatin e të gjithëve.

Tani nuk ka bir për të. Nuk e ndjen. Tani e sheh se pushteti i natës është i pafund. Tani...

Tani unë i njoh të gJORËT e mi që e njohin gJORËSINË e përplotë. Dhe në gjithë gJORËSINË e gjithë botës ati nuk e shquan birin. Tani unë dua t'i bëj të ndjeshëm por ata e dinë të vërtetën.

Dhe sakaq, si i mbyturi që humb drejtpeshimin, kam zgurdulluar sytë, shoh diku në një pikë të pamenduar, ankthprurëse. Dhe ndjej se zmadhoj shpejtësinë nga pas.

Dhe sytë e freskët të fëmijëve të mi më vadisin zemrën.

Por diç më pëshpërin në vesh ndërkaq:

Bota është një lëmsh që kalon dorë më dorë!

Por unë me marri prej prindi nuk e shqis



vështrimin nga fytyrat minore që më vadisin  
zemrën dhe sakaq, me shpejtësi llahtar bëj pas  
ndërsa panjohurisht zhduk prindërit e mi.



## Anonimati

Ndodhi diçka që realisht është e vetmja e tmerrshme: u perceptua anonimati.

E gjitha nuk ka as kuptimin më të vogël por ndjeshmëria që arrin ta përjetojë, vdes po njëherësh me përjetimin.

Kjo barrë e mundimshme të bie në kurriz menjëherë dhe fillojnë rrudhat.

Anonimati. Më vjen dëshpërimisht e plotë ideja e konstatimit se më trap se kurrë ndodhesh në rastin e këtij perceptioni.

Ja ku je, buzë rrugës. Buzë botës. Buzë qyteteve të mëdhenj nga idiocia të vegjël tmerrësisht nga tradita, cingunë prej historisë.

Por ata janë. Nuk di me çfarë e masin masën e tyre. Por janë. Ti nuk i përfill. Vlera e tyre është një përrallë e vjetëruar nga ripërtypjet e veshëve.



Asgjë interesante.

Qëndron. Konstatimi fizik i qenies sate ka pushuar. Sepse s'ke ndjeshmëri, s'ke prirje. Asgjë nuk tërheq gjë te ti, ti vetë nuk tërheq.



Megjithatë si kurrë më parë ti je një përqëndrim. Përqëndrimi më i plotë që ka ndodhur ndonjëherë nga ndodhia që ti përbën. Nga ky shëndrrim ti zhdukesh. Ti nuk je më mishi yt, por qenia që përqëndrueshëm kap atë që riprodhon ndërkaq duke pohuar anonimatën tënd total.

Nuk je. Askush s'të di. Cilësia e pafundme e shikimit tënd mund t'i vlejë gjithçkaje, madje dhe këtij nuli që në këmbë ka humbur rrugë; në këtë botë drejtimet dhe rrugët janë një marrëzi orientuese drejt kimit të suksesit (kjo "krim" i jep intonacion biblik një qeni si unë, pa kurrfarë lehje), gjithçkaje mund t'i vlejë...

Por po ndalem. S'dua të fitoj shpirt e të ndjej gjak. Isha mirë pak më parë, i asgjësuar.

Tani po shfaqem, ndoshta ngaqë lashë të rrjedh. Dhe ndërsa rrodha vetëkrijova veten.

Jam e rrjedhur. Ja zbulimi. Dhe ndërsa rrjedh krijohem. Të vjen të çmendesh! Por ja, po ftohem. Po i mbyll rrjedhat sakaq. Po ndjej përsëri, këtë herë në gjoks, plloçën anonimate.

Gjepurishtë. Gjepurishtë është fusha pa fund e shpirtit njerëzor. Shkoj nëpër të, kërkoj të ndihem, të prekem, me një fjalë kërkoj rezonim. Po rrezet ndërpriten nga objektet njerëzore,

ndërsa kisha kujtuar se një ngjarje si kjo do ishte  
ëndërr bllokuese e një insuficienti të dëshpëruar  
nga origjina.

Qëndroj. Tani as pluhur nuk mund të gjesh  
për bisedë.





## Substrati

Asgjësoj mendimet akoma pa lindur në rrethinat e kujtimeve të zëvendësuara nga një tokë proteinash që shpërbëhen në diell. Zheg. Por s'ia vlen ta përmënd.

Nuk pres, më në fund, dhe nuk bëj të presë as dikush një gjë të tillë .

Ai hyn si shantazh midis meje sepse jeta e tij është thjesht një shantazh elokuent.

Mëse një herë kam menduar se fjalët janë krijuar në mënyrë hierarkike ndërsa kuptimet e tyre janë sferike.

Kështu vagullia përsëritet pa fund në zhvillimin e shkëputjes.

Tani më lindi një ide e cila sapo u zhduk. Po të mos e mendoja s'do të zhdukej. Pres të rishfaqet. Shija e saj ishte e mrekullueshme. Akoma një

pjesë e kësaj shije më afshon në nofulla.

Sa pikante diçka e tillë: Njeriu!

“Unë nuk ju dua. Nuk është definitive, përderisa kur bëj këtë pohim nervozoj. Idetë nuk mund t’i zhvilloj më tej se mundësitë. E kuptoni? Nuk mund t’i jepem një ideje e cila s’më jep mundësi. Ndihem e fyer në këtë mënyrë. Provoj kufizim”.

Ju doni të ndiej fyerjen apo të zgjeroj mundësinë?

Nuk varet vetëm nga unë. Nëse do të ishte ashtu siç mendojmë, mendimet do të kishin shije të ëmbël, do të shijonin si ujë. Por ato janë të athta, gërryese zakonisht... Megjithëse ju nuk më lejoni të provoj shije të harruara.

Shija e mendimeve të mia, ajo që më shkaktoni, është mbi të gjitha një ngopje zgjeruese.

Ju them se më krijoni mundësi, mundësi të pafundme, por të cilat, pastaj, nuk kanë asnjë lidhje me ju.

Ju jeni diçka më vete, e pranoj..

Ndërsa ky është qyteti. Kraharor i gjerë ngrohës buzë Lanës. Gjithmonë, ngandonjëherë, kam dashur të mos e marr parasysh. Vetëm se nuk është e mundur të hedhësh poshtë gjerësinë e dashurimit lehtë me të cilën ai të prek.

Askush më mirë se një shesh i tillë qyteti nuk mund të ketë aftësinë e interpretit që nuk dënjon të flasë. Unë e kuptoj atë sepse ai më merr





parasysh mua: më lejon ta shkel. Në të gjithën ai qesh kur merr pamjen e një mendueshmërie malli. Ka gurë të përsëritur trotuari, të bindur nënështrueshëm këmbëve të mia që e përjetojnë me shije këtë bindje që ka ndodhur para se të lindin, nga detyrimi mjeshtëror i skalitësve që s'i pashë.

Mendimet janë sferike... përsëris këtë frazë që thotë se pa muzikë s'ka mendim dhe se linearet, ato, mendimet lineare, nuk janë mendime. Koha e mbushur me mendim të paekzistueshëm është jashtë, nëpër, brenda, kudo; veçanërisht kudo dëgjoj tingujt e padëgjueshëm të reales që lind e mbështjellë...

Tani e gjitha është thjeshtëzuar në anonimat. Duket e pakuptueshme por të qenit kështu do të thotë të mos jesh. Mund të pohoj se vetëm një esencë pozitive ka mbetur tek unë, që kërkon ndërvarje.

Unë dua të ndërlidhem por është e pamundur. Ka kohë që dua të ndiej mbështetjen e një ekuilibri, por kjo arsye morale nuk i përgjigjet arsyes fizike. Arsyeja fizike është një mohim i gjithë asaj që kërkoj, kurse me shpirt?

A mundem unë të them se Ai tha kështu, kurse Unë ashtu?

E rëndë. Më duket sikur më ndryshoi fytyra.

Keni parë shumë. Kjo është merita e çdo humbjeje dhe humbja e çdo merite. Dikush e ka fyer eksperiencën, por ... gjithsesi zhdukja mund



të lërë pak vend për etikë.

Tani u krodhët në një mendueshmëri retorike. Akoma nuk keni krisatalizuar një frazë por mishi juaj u ftoh. Tani mendoni vetëm me tru.

Keni një tru të ngritur, të ngjashëm me kafshën kur përgjon rrezikun. Por ky është një refleks i pavullnetshëm, sepse zakonisht ju nuk e vrisni fare, madje jeni tipike për këtë.

Ato që ju mendoni s'mund të quhen mendime. Ajo është përpjekja juaj për të mbërrirë diçka që i ngjan një zgjidhje dhe që në të vërtetë ty të hap një mori problemesh. Kjo është zgjidhja juaj, moria e problemeve.

Doni të mendoni? D.m.th. doni të mendoni në mënyrë konkrete? Është e vështirë, sepse është shumë turp. Akoma nuk gjeni një gjë që ta mendoni dhe të mos turpëroheni. As edhe një. Një njeri të vetëm!

Dikur e ëndërronit këtë, kurse tani nuk ju bën as përshtypje. Do të ishte e çuditshme të donit dikë, dhe pikërisht tani ju keni aq nevojë për të dashur, por ...

Shtëpia ishte prej lënde të butë, e thënë keq. Ishte prej kartushi. Diçka e ngjashme me kutinë ku strehohen vezët.

Ishte zëri i tij ai që e krijoi këtë ide për shtëpinë, sepse zëri i tij ishte më i trashë se muret dhe ju u drodhët:

Nga zëri? Jo.





Nuk ishte tonaliteti. Ju u drodhët nga e papritura.

Zëri i tij ishte i papritur. Nuk ishte i trashë. Ishte më i papritur se muret. Zëri i tij ishte vullneti dhe ju u tmerruat nga zgjimi.

Ju kishit vite që flinit. Këtë e kuptoni tani, nga kujtimi i aq ëndrrave të këqia, që kishit parë, dhe pastaj nga kujtimi i një ëndrre të lumtur. Nuk ka ëndrra të këqia dhe të lumtura. Nuk ka ëndrra, ka vetëm një gjerësi të cilën zemra e zmadhon ose e ngushton deri në pambarim. Do të thoja se edhe fundi është zhdukja e pikëllimit fizik që ndjek njeriun: trupi.

Ka shumë pamundësi për të folur në mënyrë konkrete.

Do të ishte i madh faji sikur të thosha: ai ishte Një:

Tani përshtypja ime konkrete është rrafshuar. Tani gjendja ime di shumë, kurse unë asgjë. Pra nuk kam për kë të flas dhe kujt t'i referohem.

Do të ishte gjëja më e çuditshme që Ju të ndodheshit këtu. Ne asnjëherë nuk ndërmorem.

Kishit një hapësirë të errët në fund të dhëmballëve. Ishte pika më e errët që nxinte midis së qeshurës suaj të gjerë. Ju jepeshit vetëm kur qeshnit. Ky është kujtimi i vetëm që kam nga ju. I vetmi. Gjithçka tjetër është mbetje, të cilën unë do ta fshija shkujdesur, sikur...

Ju kam njohur nga e qeshura. Në të kundërt

asgjë s'do të mund të krijonte besim, aq sa për t'ju dëgjuar buzë një tryeze.

o o o

Qëndroj para pasqyrës. Vështrimi im turbullohet pandërprerë vetëm që të mos pajtohet me atë që shoh. Ideja për veten është më e përsosur se paraqitja ime. Papushim. E njëjta braktisje për të kërkuar një vete të paekzistueshëm.

Sikur të kisha një ngjarje, vetëm një. Kam mall për aktin e shqisave kur tensionohet truri. Por ai nuk lëviz. Rekëtimat e tij janë të dobëta, kurse unë... Unë e kam rrethuar trurin tim me trup dhe me eshtra dhe s'e lë të marrë frymë. Unë, unë i kam dobësitë. Nevojat janë të miat, jo të tij.

O zot, çfarë shpirti është ai, truri im. Do të doja të rrija me të, por asgjë s'më lejon. Ai e prodhon qetësinë më lehtësisht se sa unë skandalin.

o o o

Qëndroj. Sytë dikur më shihin qartë, tani jo qartë.

Unë dua të rri këtu, me trurin tim, por e di, do të mbarojë. Do të ketë fund dashuria, truri dhe prehja. Truri im që kurrsesi s'e mendoj të mbarueshëm. Të gjitha i mbaroj dhe i vë në zhdukje, kurse atë jo. Jam skllav i tij, lotët për të mërrjedhin. Më përmallon në mënyrë të





tmerrshme ideja se mund të takoj trurin tim. Do të kemi kohë një ditë, do ta dëgjoj gjatë. Dhe atëherë koha do të krijohet prej meje. S'do të ketë kohë të shtrirë përpara, as kujtesë. O Zot, a thua kaq gjë është lumturia?

